

VENDIM
Nr.278, datë 28.4.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT 2010, PËR
BASHKËSITË FETARE QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 140, datë 15.5.2009 "Për financimin nga Buxheti i Shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave", të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Buxheti prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, i miratuar për financimin e bashkësive fetare, për vitin 2010, të përdoret sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, e sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë, të ndarë:

i) 18 360 000 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e administratës;

ii) 9 640 000 (nëntë milionë e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë, për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit, në Durrës, Has, Kolonjë, Tropojë-Degë etj.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 24 000 000 (njëzet e katër milionë) lekë, të ndarë:

i) 22 680 000 (njëzet e dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e administratës;

ii) 1 320 000 (një milion e treqind e njëzet mijë) lekë, për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 24 000 000 (njëzet e katër milionë) lekë, të ndarë:

i) 3 348 000 (tre milionë e treqind e dyzet e tetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e administratës;

ii) 20 652 000 (njëzet milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë, për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 24 000 000 (njëzet e katër milionë) lekë, të ndarë:

i) 4 320 000 (katër milionë e treqind e njëzet mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e administratës;

ii) 12 680 000 (dymbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit "Odeoni";

iii) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore me qendër në Tiranë, dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

I. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me shumën prej 28 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën prej 18 360 000 lekësh, për 170 punonjës.

2. Për rikonstrukcion dhe mirëmbajtjen e objekteve të kultit në shumën prej 9 640 000 lekë për objektet e mëposhtme:

a)	Xhamia Krumë, Has	2 836 890 lekë
b)	Xhamia Selishtë	2 022 510 lekë
c)	Xhamia Fatih, Durrës	1 623 491 lekë
d)	Xhamia Ishëm, Durrës	1 617 000 lekë
e)	Xhamia Degë, Tropojë	1 540 109 lekë.

II. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë me shumën prej 24 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën prej 22 680 000 lekësh për 210 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën prej 1 320 000 lekësh, për 12 punonjës.

III. Kisha Katolike me shumën prej 24 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën prej 3 348 000 lekësh për 31 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën prej 20 652 000 lekësh, për 191 punonjës.

IV. Kryegjyshata Botërore Bektashiane me shumën prej 24 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën prej 4 320 000 lekësh për 40 punonjës.

2. Për rikonstrukcion e mirëmbajtje të objekteve të kultit në shumën prej 12 680 000 lekësh, për objektin "Odeon".

3. Për Kryegjyshitën Botërore si kryeqendër, për veprimtari ndërkombëtare, në shumën prej 7 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

a)	Veprimtaria ndërkombëtare për 800 vjetorin e H. Bektash Veliut	1 850 000 ekë
b)	Kongresi Botëror i Bektashinjve	4 000 000 lekë
c)	Për udhëtime e pritje të Kryegjyshit shumën prej	1 150 000 lekësh.